



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2022:084738

Datë: 03.10.2023

Numri i dokumentit: 04746851

P.nr.1152/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, në lëndën penale të pandehurës M.S.-K. nga F.K. e akuzuar për veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par 8 lidhur me par 6 të KPRK-së duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.950/22 të datës 23.05.2022, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestare në praninë e Prokurorit të Shtetit Lulzim Aliu të pandehurës M.S.-K. me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare av Remzush Spahiu dhe të dëmtuarës I.T. me datë 29.09.2023 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 02.10.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E pandehura M.S.-K e bija e M. dhe nëna M. e gjinisë J. e lindur me ..., në K. me vendbanim në F.K. kompleksi “..” .. kati .. me numër personal ... të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer fakultetin e edukimit, e martuar, nëne e një fëmije, e punësuar si mësuese, e gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R E

Për shkak se:

Më datë 05.07.2021 rreth orës 13:30min në rrugën “...” në F.K. e pandehura duke drejtuar automjetin e tipit “...” ngjyrë hirit me targa të regjistrimit ... e cila ishte duke lëvizur nga drejtimi i çerdhes në drejtim të shkollës “M.G.” dhe kur kishte arritur te lokali “F.” me pjesë e përparme të anës së majtë e kishte goditur këmbësoren I.T. e cila ishte duke kaluar rrugën nga ana e majtë në të djathtë në drejtimin e lëvizjes së automjetit, nga pakujdesia ashtu që duke drejtuar automjetin në këtë rrugë për shkak të mos përshtatjes së shpejtësisë me gjendjen e rrugës si dhe duke mos pasur kujdes të duhur ndaj pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion në këtë rast ndaj këmbësorëve ka shkaktuar aksident trafikur ku me ç ‘rast i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore të dëmtuarës I.T.

- Me çka ka kryer veprën penale *rrezikim i trafikut publik* nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9,10 par.1, 17 par.1, 23 par.1 dhe 2, 38, 39 par.1 nen par.1.1, 40 par.1 nen par. 1.2, 43, 44, 69, 70, 71 par.1 nen par.1.2 dhe 1.3, 72 dhe nenit 370 par.8 lidhur me par.6 të KPRK-së dhe neneve 240, 241, 242 par. 1 dhe 6, 358, 359, 360, 361 dhe 364 të KPPRK-së, të pandehurën:

E GJYKON

- I.** Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarës është zëvendësuar ne dënim me gjobë, ashtu që Gjykata të akuzuarës i shqipton dënim me gjobë në shumën prej njëmijë e pesëqind (1500) Euro, të cilin dënim e njëjta është e obliguar që të paguaj me dy (2) këste nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II.** Nëse e akuzuara nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje t' a paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimin me gjobë do të i zëvendësohet me dënim me burg ashtu që për çdo 20 € (njëzet euro) do të i caktohet një ditë burgim.
- III.** Obligohet e akuzuara që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.
- IV.** E dëmtuara I.T. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.950/22 të datës 23.05.2022 ndaj te pandehurës M.S.-K nga F.K. për shkak të veprës penale *rrezikim i trafikut publik* nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 të KPRK-së.

Gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me date 26.09.2023 ne pranin e prokurorit te Shtetit, te pandehurës M.S.-K me mbrojtësin e saj sipas detyrës zyrtare av. Remzush Spahiu dhe te dëmtuarës I.T.

Pas leximit te aktakuzës nga ana e prokurorit e pandehura u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale me te cilën akuzohet.

Pas deklarimit te pandehurës dhe mendimit te prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se e pandehuri pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, e pandehura është e vetëdijshme për pasojat e pranimin te fajësisë, si dhe te gjitha kërkesat nga neni 242 par. 2 te KPPRK-se janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovoj deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurës.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë

ne këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të të pandehurës se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara si ekspertiza e komunikacionit e datës 24.04.2022, ekspertiza mjekoligjore e datës 20.04.2022, deklarata e të dëmtuarës e datës 08.07.2021, raportet mjekësore të të dëmtuarës dhe me shkresat e tjera të lëndës e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, rrjedh se në veprimet e të pandehurës M.S.-K qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale *rrezikim i trafikut publik* nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 të KPPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se e pandehura e ka kryer veprën nga pakujdesia, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurës, kështu që e njëjta është penalisht përgjegjëse.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 të KPPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurën, gjykata ka vlerësuar faktin se e njëjta më parë kishte sjellje korrekte dhe nuk kishte rënë asnjëherë në konflikt me ligjin, si dhe e pandehura ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier e përgjegjshme për veprime e saj dhe duke shpreh keqardhje për veprën që e ka kryer. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të pandehurës që bënë që dënimi të bie në minimumin e paraparë ligjor. Rrethana rënduese gjykata nuk gjeti.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata në kuptim të nenit 70 të KPPRK-së të pandehurën e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit. Gjykata në rastin konkret ka aplikuar dispozitën e nenit 71 të KPPRK-së për zbutjen e dënimit, meqenëse rrethanat e lartcekura gjykata i konsideroj si rrethana posaçërisht lehtësuese.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurës është në përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të saj dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurës në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPPRK-së.

Gjykata vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor e mori në bazë të nenit 449 par.2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 36 par.3 nën par.3.1 Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontestin juridiko- civil, gjykata e mori në bazë të nenit 462 par.2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA FUSHË KOSOVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.1152/22, datë 03.10.2023

Gjyqtarja Gjykuese

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të të njejtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2022:084738
Datë: 03.10.2023
Numri i dokumentit: 04746851